



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr. _____ prot

Lushnje, më ____/____/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“ Blerje Gazoili për Mjetet e Bashkisë Lushnjë dhe MZSH-së ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0 Karburant

VLERA E FONDIT LIMIT:

4 008 934 (katër milion e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër)lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Bashkia Lushnje” , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën njerin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 40% e vlerës së parashikuar të kontratës **4 008 934** (katër milion e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në **nenin 77 pika 3 i LPP**, si dhe **nenin 43 pika 2 (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.**

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet **2023- 2024** të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Nisur nga objekti i prokurimit, rëndësia e tij për vënien në punë të mjeteve për kryerjen e operacioneve të punës, kërkohet ky dokument për të provuar fuqinë dhe kapacitetin ekonomik për të përballuar kërkesat për furnizim të vazhdueshëm për karburant.

2.3 Kapaciteti teknik:

22.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, **801 786.8** (tetëqind e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje tetë) **lekë pa tvsh**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Pika 2.3.1 Bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020 “Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1/“c” dhe pika 4 si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik “, i ndryshuar neni 55 pika 4 (b). Kërkesa për dëshmi të furnizimeve të mëparshme të ngjashme, lind si domosdoshmëri për të faktuar se OE disponojnë eksperiencën dhe kapacitetin e duhur në fushën e tregtimit të karburanteve, për të përballuar kërkesat e Autoritetit Kontraktor për mallin në fjalë, objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **leje tregtimi ose licencat përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve**, gazit të lëng-shëm të naftës, **për automjetet**, vajrave lubrifikant dhe nenprodukteve të saj ose autorizim për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel 10ppm) në përputhje me Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 « Për perpunimin, transportin dhe tregtimin të gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve të tyre » (me ndryshimet përkatëse) sipas standarteve të miratuara konform ligjit.

Arsyetimi: Kërkesa për këtë lloj licence të tregtimit me pakicë të karburanteve, behet me qëllim të sigurimit të një pjesëmarrje sa më të gjerë të OE.

Pika 2.3.2 është vendosur në përputhje me ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve të tyre” i ndryshuar neni 10, 19, 20 si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 5/“a”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Flete analize ose **raport analize i cilesise se diesel 10 ppm ULSD** lëshuar nga organet kompetente, e lëshuar jo më parë se 12 muaj nga data e hapjes së tenderit.

b. Vërtetim teknik nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit bazuar në përcaktimet e VKM-së nr.491 datë 19.07.2017 "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së naftës, instalimeve të nën presion, që shërbejnë për perpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e gazit dhe nenprodukteve të tyre", specifikisht në Kreu V, kontrolli për

respektimin e kushteve teknike te karburantit.

Arsyetimi:

Bazuar në ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre” (i ndryshuar), V.K.M Nr.970 date 02.12.2015 “Per percaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj”, VKM-në nr.491 datë 19.07.2017 "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së naftës, instalimeve të nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e gazit dhe nënprodukteve të tyre" ,ne Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020“Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 4,i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 6/”c”,I ndryshuar

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te siguroje furnizim te pandërprere 24 ore,ne 7 dite te javes,ne qytetin ku ndodhet Autoriteti Kontraktor si dhe ne te gjitha stacionet e shitjes se karburanteve me pakice me pistolete publike (ku ai ushtron veprimtarine),kundrejt paraqitjes dhe cekimit te kartes elektronike te personalizuar me targa e automjetit te Autoritetit Kontraktor dhe se karta elektronike nuk ka afat skadence.

Arsyetimi:

Pika 2.3.4 eshte vendosur ne perputhje me Ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre”(i ndryshuar), ne Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020“Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1/”c”.Specifikimet jane marre nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qera te provuar me dokument ligjor(Ekstrakti tregtar i QKR-se i shoqeruar me dokument pronesie ose kontrate qeraje) se **paku nje pike furnizimi brenda territorit te Qytetit Lushnje** me afat vlefshmerie per te gjithë afatin e zbatimit te kontrates per kete objekt prokurimi.

Arsyetimi:

Pikat 2.3.5 eshte vendosur ne perputhje me Ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre”(i ndryshuar);

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ofroje një faqe menaxhimi te karburanteve (Webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet **nëpërmjet kartës elektronike**, (bazuar ne VKM-ne nr.561,date 29.07.2016 *Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme*”)

Arsyetimi:*Pikat 2.3.6 eshte vendosur ne perputhje me VKM-ne nr.561,date 29.07.2016 Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme”.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasinë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (e ndryshuar)”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP.***

Ligji Nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre”(i ndryshuar); Ligjin nr.118/2012 date 13.12.2012 “Per transportin e mallrave te rrezikshem ”, VKM-ne nr.561,date 29.07.2016 Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme”

NJËSIA E PROKURIMIT :